



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GRACANICA

Numri i lëndës: 2023:238007
Datë: 10.01.2025
Numri i dokumentit: 06696002

K.nr.425/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA GRAQANICË– DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE, në përbërje të gjyqtarit individual Rustem Begolli, me pjesëmarrjen e zyrtarës ligjore Blerta Bekteshi , në procedurën kundërvajtëse kundër A. A. V. , për shkak të veprës kundërvajtëse nga neni 231 par.5 të LRRTRR, (Ligji nr. 05/L-088) dhe nenit 19 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e LRRTRR (Ligji nr.06/L-069), në bazë të neneve 55,77,86,119,124 dhe 127 të Ligjit për Kundërvajtje nr. 05/L-087, më datë 16.07.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri A. A. V. , i lindur më dt..... në Prishtinë, me vendbanim në Qagllavicë në rrugën rruga e tretë shtëpia e parë KK Graqanicë, shqiptar shtetas i R. Kosovës , i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike me numër personal .

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse më datë 29.09.2023, rreth orës 14.00 në rrugën te pompa e benzinës RT në Qagllavicë,gjersa ishte duke e drejtuar automjetin e tipit Porche, me targa të regjistrimitPM, është ndaluar nga njësitë i trafikut rrugor, me ç’rast pas kërkimit të dokumentacionit të automjetit, është konstatuar se i njëjti ka drejtuar automjetin e lartpërmendur pa patentë shoferi përkatësisht pa e fituar të drejtën për drejtimin e automjetit.

- me çka ka kryer veprën kundërvajtëse nga neni 231 par. 5 të LRRTRR-së(Ligji nr. 05/L-088) dhe nenit 19 të Ligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor(Ligji.nr.06/L-069.)

- andaj në bazë të dispozitave të theksuara ligjore si dhe nenit 35 par.1 të Ligjit për Kundërvajtje.

D Ë N O H E T
ME DËNIM ME TË HOLLA në shumë prej 300 € (Treqind euro)

Dënimin e shqiptuar në të holla , ka për t'a paguar në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse nuk e paguan në afatin e përcaktuar, do të zbatohet përmbarimi i detyrueshëm në pajtim me dispozitat e ligjit për përmbarim.

I pandehuri, obligohet që në emër të shpenzimeve paushalle të paguaj shumën prej 5 € (pesë euro) në afatin e njëjtë sikurse denimin në të holla në kuptim të nenit 59 dhe 76 të LK-së.

Nga një ekzemplarë i këtij aktgjykimi u dërgohet palëve.

A r s y e t i m i

Stacioni Policor NJRKR Prishtinë, kësaj gjykate i ka parashtruar kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse nr....., datë **29.09.2023** kundër të pandehurit të lartëshenuar, për shkak të veprës kundërvajtëse nga neni 231. par.5 të LRRTRR, me të cilën ka kërkuar që pranë kësaj gjykate të mbahet shqyrtimi gjyqësor dhe pas administrimit të provave të propozuara, i njëjti të shpallet përgjegjës dhe të dënohet sipas dispozitave ligjore.

Gjyqtari, filloi procedurën kundërvajtëse, muarr në pyetje të pandehurin i cili në deklaratën-mbrojtjen e tij, në tërësi pranoi veprën kundërvajtëse e cila i ngarkohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi andaj për këtë nuk pati nevojë që të administrohen prova tjera. Njëherit i ka premtuar gjykatës se nuk do të marrë pjesë më në komunikacion për deri sa nuk kualifikohet për drejtimin e automjetit.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, deklaratës së të pandehurit si dhe kërkesën e stacionit policor, gjyqtari i çështjes erdhi në përfundim se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha elementet e veprës kundërvajtëse të parapara sipas dispozitave të nenit 231 par.1 lidhur me par. 5 të LRRTRR, dhe neni 19 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, ashtu që të pandehurin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e shqiptimit të dënimit, gjyqtari mori parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 31 dhe 35 të Ligjit për Kundërvajtje e sidomos peshën e veprës kundërvajtëse dhe pasojat, rrethanat nën të cilat është kryer kundërvajtja, gjendjen e tij personale si dhe atë pasurore, shkallën e përgjegjësisë dhe tiparet personale të tij , pranimin e fajësisë, është penduar dhe ka premtuar se nuk do t'a përsëris mënjë veprim të tillë, andaj bazuar në të gjitha këto rrethana, të pandehurit iu shqiptua një dënim i tillë me bindje se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi ndëshkimor.

Zyrtarja Ligjore
Blerta Bekteshi

Gjyqtari
Rrustem Begolli

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtroj ankesë paraqitësi i kërkesës dhe i pandehuri, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit në Gjykatën e Apelit-Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.